



UNIVERSITETI - UNIVERSITET - UNIVERSITET
"HAXHI ZEKA"



TRYEZË DISKUTIMI

IDENTIFIKIMI I NEVOJAVE PËR FUQIZIMIN E KOMPONENTES SË MENAXHIMIT HOTELIER

ANALIZË EMPIRIKE E SEKTORIT HOTELIER NË KOSOVË



AGENDA



10:30 – 10:45

Hapja e tryezës – fjalët hyrëse
Rektori i UHZ



10:45 – 11:15

Prezantimi i gjetjeve të hulumtimit empirik
*Universiteti "Haxhi Zeka" – Fakulteti i
Menaxhimit të Turizmit, Hotelerisë dhe
Mjedisit (UHZ-FMTHM)*



11:15 – 11:45

Panel diskutimi
*Përfaqësues të institucioneve
dhe sektorit hotelier*



11:45 – 12:15

Diskutim i hapur
Pyetje dhe komente nga pjesëmarrësit



12:15 – 12:30

Përmbyllja e tryezës dhe konkluzionet
UHZ & FMTHM



08.07.2026



10:00



HOTEL DUKAGJINI,
PEJË



*Së bashku ndërtojmë
kuadro profesionale për
hotelerinë e së nesërmes.*





HYRJJE

Në një mjedis ekonomik dhe shoqëror që karakterizohet nga ndryshime të vazhdueshme, universitetet përballen me përgjegjësinë për të zhvilluar programe studimore që jo vetëm transmetojnë dije, por edhe përgatisin profesionistë të aftë për t'iu përgjigjur kërkesave reale të tregut të punës. Kjo përgjegjësi është veçanërisht e rëndësishme në sektorët që po zhvillohen me ritëm të shpejtë, si hoteleria, ku cilësia e burimeve njerëzore mbetet një nga faktorët kryesorë të suksesit dhe konkurrueshmërisë.

Në këtë kontekst, identifikimi i nevojave të industrisë dhe përfshirja e tyre në procesin e zhvillimit të programeve studimore nuk përbën vetëm një praktikë të mirë akademike, por një domosdoshmëri për institucionet e arsimit të lartë. Dialogu me punëdhënësit, analizimi i zhvillimeve të sektorit dhe mbështetja e vendimmarrjes në evidencë krijojnë mundësi që universiteti të ndërtojë programe studimore të qëndrueshme, relevante dhe të orientuara drejt kompetencave profesionale.

Pikërisht mbi këtë qasje u mbështet edhe iniciativa e Fakultetit të Menaxhimit të Turizmit, Hotelierisë dhe Mjedisit në Universitetin "Haxhi Zeka", i cili ndërmori një hulumtim me qëllim

identifikimin e nevojave aktuale të sektorit hotelier dhe vlerësimin e përputhshmërisë së programeve studimore me kërkesat e tregut të punës. Përmes përfshirjes së përfaqësuesve të industrisë, hulumtimi krijoi një bazë të besueshme informacioni mbi kompetencat profesionale që kërkojnë nga punëdhënësit, sfidat me të cilat përballlet sektori dhe pritshmëritë për zhvillimin e kuadrove të ardhshme.

Rezultatet e këtij hulumtimi shërbyen si pikënisje për organizimin e tryezës së diskutimit **"Fuqizimi i Menaxhimit Hotelier në Arsimin e Lartë – Zhvillimi i Kompetencave Profesionale dhe Harmonizimi i Kurrikulave me Tregun e Punës"**, e mbajtur më 8 korrik 2026, me organizim të Fakultetit të Menaxhimit të Turizmit, Hotelerisë dhe Mjedisit në Universitetin "Haxhi Zeka". Aktiviteti mbledhi në një forum të përbashkët përfaqësues të institucioneve publike, komunitetit akademik, organizatave profesionale dhe industrisë hoteliere, duke krijuar një hapësirë për diskutim të hapur mbi sfidat, mundësitë dhe drejtimet e zhvillimit të arsimit universitar në këtë fushë.

Ndryshe nga aktivitetet që kufizohen në prezantimin e qëndrimeve institucionale, kjo tryezë u ndërtua mbi rezultatet e një analize empirike, duke e orientuar debatin drejt çështjeve konkrete që ndikojnë në zhvillimin e programeve studimore dhe përgatitjen e kuadrove profesionale. Gjetjet e hulumtimit u trajtuan si bazë për diskutim, ndërsa kontributet e panelistëve, të ardhur nga institucione të ndryshme dhe nga vetë industria, pasuruan analizën me përvoja praktike dhe këndvështrime profesionale mbi sfidat dhe prioritetet e sektorit.

Ky raport paraqet në mënyrë kronologjike zhvillimin e aktivitetit, përmbledh çështjet kryesore të trajtuara gjatë diskutimeve dhe evidenton përfundimet që dolën nga bashkëbisedimi ndërmjet akademisë, institucioneve publike dhe industrisë. Në të njëjtën kohë, ai dokumenton një iniciativë që synon të forcojë kulturën e vendimmarrjes së mbështetur në evidencë dhe të kontribuojë në zhvillimin e programeve studimore që i përgjigjen nevojave të shoqërisë dhe tregut të punës.

QËLLIMI I AKTIVITETIT

Tryeza e diskutimit u organizua me synimin për të krijuar një platformë të përbashkët bashkëpunimi ndërmjet universitetit, institucioneve publike dhe industrisë hoteliere për të analizuar nevojat aktuale të sektorit dhe për të diskutuar mënyrat e avancimit të programeve studimore në fushën e menaxhimit hotelier. Aktiviteti synoi të nxisë një dialog të bazuar në evidencë ndërmjet aktorëve kryesorë të sektorit, duke vendosur në qendër të diskutimit përgatitjen e kuadrove profesionale dhe harmonizimin e kompetencave të studentëve me kërkesat reale të tregut të punës.

Njëkohësisht, tryeza kishte për qëllim të prezantojë rezultatet e hulumtimit të realizuar nga Fakulteti i Menaxhimit të Turizmit, Hotelerisë dhe Mjedisit, duke i shndërruar gjetjet empirike në bazë për diskutime profesionale dhe për formulimin e rekomandimeve konkrete që mund të shërbejnë në procesin e zhvillimit të programeve studimore dhe forcimit të bashkëpunimit universitet–industri.

Përmes këtij aktiviteti, Universiteti "Haxhi Zeka" synoi të riafirmojë rolin e tij si institucion që jo vetëm përgatit kuadro profesionale, por edhe krijon hapësira të dialogut ndërmjet akademisë dhe sektorit privat për adresimin e sfidave që ndikojnë në zhvillimin e arsimit të lartë dhe të industrisë së hotelierisë në Kosovë.

OBJEKTIVAT KRYESORE

Organizimi i tryezës ishte i orientuar drejt realizimit të disa objektivave konkrete, të cilat udhëhoqën edhe zhvillimin e diskutimeve gjatë aktivitetit:

- Prezantimi i rezultateve të hulumtimit **"Identifikimi i nevojave për fuqizimin e komponentes së menaxhimit hotelier"**, si bazë për diskutim dhe vendimmarrje akademike.
- Analizimi i kompetencave profesionale që kërkohen aktualisht nga industria hoteliere dhe identifikimi i profileve më të nevojshme për tregun e punës.
- Vlerësimi i përputhshmërisë së programeve ekzistuese studimore me zhvillimet bashkëkohore të sektorit hotelier dhe me kërkesat e punëdhënësve.
- Diskutimi mbi rëndësinë e praktikës profesionale si komponent thelbësor në përgatitjen e studentëve dhe identifikimi i mekanizmave për zgjerimin e bashkëpunimit me bizneset.
- Promovimi i dialogut ndërmjet universitetit, institucioneve publike, organizatave profesionale dhe industrisë, me qëllim krijimin e partneriteteve të qëndrueshme në funksion të zhvillimit të arsimit të lartë.
- Formulimi i rekomandimeve për përmirësimin e kurrikulave, zhvillimin e profileve të specializuara në menaxhimin hotelier dhe fuqizimin e bashkëpunimit universitet–industri si një nga mekanizmat kryesorë për rritjen e cilësisë së arsimit dhe punësueshmërisë së të diplomuarve.

ORGANIZIMI I AKTIVITETIT

Tryeza e diskutimit **"Fuqizimi i Menaxhimit Hotelier në Arsimin e Lartë – Zhvillimi i Kompetencave Profesionale dhe Harmonizimi i Kurrikulave me Tregun e Punës"** u organizua më **8 korrik 2026** në ambientet e Hotelit **"Dukagjini"** në Pejë, me organizim të Fakultetit të Menaxhimit të Turizmit, Hotelierisë dhe Mjedisit të Universitetit "Haxhi Zeka". Aktiviteti filloi me pritjen dhe regjistrimin e pjesëmarrësve, duke krijuar mundësinë për komunikim dhe shkëmbim të përvojave ndërmjet përfaqësuesve të institucioneve publike, industrisë hoteliere dhe komunitetit akademik.

Në aktivitet morën pjesë drejtues të Universitetit "Haxhi Zeka", përfaqësues të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, përfaqësues të organizatave profesionale të hotelierisë dhe turizmit, menaxherë të hoteleve dhe bizneseve të sektorit, drejtues të institucioneve arsimore, ekspertë të industrisë, profesorë universitarë dhe përfaqësues të sektorit privat. Kjo përbërje shumësektoriale krijoi mundësinë që çështjet e trajtuara të analizoheshin nga perspektiva akademike, institucionale dhe profesionale, duke pasuruar diskutimin me përvoja konkrete nga praktika.

Që në fillim të aktivitetit u evidentua se sfidat që lidhen me përgatitjen e kuadrove profesionale nuk mund të adresohen vetëm nga universiteti ose vetëm nga industria. Për këtë arsye, tryeza u konceptua si një forum bashkëpunimi, ku secili pjesëmarrës solli përvojën dhe perspektivën e tij mbi zhvillimin e kompetencave profesionale, përmirësimin e praktikës së studentëve dhe harmonizimin e programeve studimore me kërkesat e tregut të punës.

HAPJA ZYRTARE E TRYEZËS

NJË DIALOG NDËRMJET AKADEMISË DHE INDUSTRIËS

Pas pritjes dhe regjistrimit të pjesëmarrësve, tryeza filloi zyrtarisht në orën 10:00, duke shënuar nisjen e një diskutimi që kishte në qendër një nga temat më aktuale për arsimin e lartë në Kosovë, përgatitjen e kuadrove profesionale për sektorin e hotelierisë dhe nevojën për harmonizimin e programeve studimore me zhvillimet e tregut të punës. Që në hapje u theksua se zhvillimi i sektorit hotelier nuk mund të trajtohet vetëm si çështje ekonomike apo turistike, por edhe si një sfidë arsimore, e cila kërkon bashkëpunim të vazhdueshëm ndërmjet universiteteve, institucioneve publike dhe industrisë.

Programi i aktivitetit u konceptua në mënyrë që diskutimet të ndërtoheshin mbi rezultatet e hulumtimit të realizuar nga Fakulteti i Menaxhimit të Turizmit, Hotelierisë dhe Mjedisit, ndërsa kontributet e panelistëve të ofronin perspektiva të ndryshme mbi mënyrën se si arsimi universitar mund të përmbushë më mirë nevojat e sektorit hotelier. Kjo qasje krijoi një lidhje të natyrshme ndërmjet evidencës empirike, përvojës institucionale dhe praktikës profesionale, duke e orientuar diskutimin drejt identifikimit të zgjidhjeve konkrete.

PANELI I DISKUTIMIT

Paneli i diskutimit u konceptua në mënyrë që të përfaqësoheshin të gjitha palët që kontribuojnë në zhvillimin e sektorit hotelier, përfshirë institucionet publike, organizatat profesionale, bizneset, arsimin profesional dhe universitetin. Kjo përbërje mundësoi trajtimin e temës nga këndvështrime të ndryshme dhe krijoi një debat të balancuar mbi sfidat dhe perspektivat e zhvillimit të menaxhimit hotelier në arsimin e lartë.

PROF. DR. ARMAND KRASNIQI

Prof. Dr. Armand Krasniqi shërben si Rektor i Universitetit "Haxhi Zeka" dhe është profesor i rregullt në fushën e së drejtës biznesore. Me një përvojë të gjatë akademike dhe drejtuese, ai ka dhënë kontribut të rëndësishëm në ndërtimin dhe zhvillimin institucional të universitetit, duke mbajtur më parë detyrën e Dekanit të Fakultetit të Shkencave të Aplikuara të Biznesit dhe të Kryesuesit të Këshillit të Përkohshëm Drejtues. Gjatë mandatit të tij si rektor, universiteti ka shënuar përparim në rritjen e cilësisë akademike, ndërkombëtarizimin, zgjerimin e bashkëpunimit me partnerë vendorë dhe ndërkombëtarë, si dhe në zhvillimin e programeve studimore në përputhje me standardet evropiane të arsimit të lartë.

UNIVERSITETI SI PARTNER NË ZHVILLIMIN E SEKTORIT HOTELIER

Tryeza u hap nga Rektori i Universitetit "Haxhi Zeka", **Prof. dr. Armand Krasniqi**, i cili, në fjalën e tij përshëndetëse, e vendosi në fokus përgjegjësinë që universitetet publike kanë në raport me zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të vendit. Ai theksoi se roli i universitetit nuk përfundon me diplomimin e studentëve, por vazhdon përmes krijimit të programeve studimore që i përgjigjen transformimeve të tregut të punës dhe nevojave të sektorëve strategjikë të ekonomisë.

Në këtë kontekst, Rektori vlerësoi organizimin e tryezës si një hap të rëndësishëm drejt forcimit të dialogut ndërmjet universitetit dhe industrisë hoteliere. Sipas tij, zhvillimi i programeve studimore duhet të mbështetet në komunikim të vazhdueshëm me punëdhënësit, në mënyrë që studentët të përfitojnë kompetenca që u mundësojnë integrim të shpejtë dhe të suksesshëm në tregun e punës.

Ai nënvizoi se Fakulteti i Menaxhimit të Turizmit, Hotelerisë dhe Mjedisit ka ndërtuar ndër vite një traditë bashkëpunimi me sektorin privat dhe se aktivitetet si kjo tryezë dëshmojnë orientimin institucional të Universitetit "Haxhi Zeka" drejt zhvillimit të arsimit të bazuar në partneritet, inovacion dhe përgjegjësi shoqërore. Në këtë drejtim, rezultatet e hulumtimit të prezantuar gjatë aktivitetit u konsideruan një burim i rëndësishëm informacioni për zhvillimin e mëtejshëm të programeve studimore dhe për fuqizimin e komponentes së menaxhimit hotelier në kuadër të fakultetit.



MUHEDIN NUSHI

Muhedin Nushi është Këshilltar i Lartë në Ministrinë e Kulturës dhe Turizmit të Republikës së Kosovës. Me një përvojë të gjatë në administratën publike dhe menaxhimin institucional, ai ka dhënë kontribut në hartimin dhe zbatimin e politikave publike, zhvillimin institucional dhe promovimin e sektorit të turizmit. Gjatë karrierës së tij ka ushtruar funksione të rëndësishme drejtuese në nivel lokal dhe qendror, duke qenë i angazhuar në modernizimin e administratës publike, zhvillimin e projekteve strategjike dhe forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional. Në rolin e tij aktual, ai kontribuon në avancimin e politikave për zhvillimin e turizmit dhe promovimin e Kosovës si destinacion turistik, përmes bashkëpunimit me institucionet vendore dhe partnerët ndërkombëtarë.

POLITIKAT PUBLIKE DHE ZHVILLIMI I KAPITALIT NJERËZOR

Në vijim të programit, pjesëmarrësit u përshëndetën nga **Muhedin Nushi**, Këshilltar i Lartë në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, i cili paraqiti këndvështrimin institucional mbi zhvillimin e kapitalit njerëzor në sektorin e hotelerisë dhe turizmit. Ai evidentoi se zhvillimi i qëndrueshëm i këtij sektori nuk mund të mbështetet vetëm në investime infrastrukturore apo në promovimin e destinacioneve turistike, por kërkon edhe investim sistematik në përgatitjen profesionale të burimeve njerëzore.

Në diskutimin e tij u theksua se politikat publike duhet të ndërtohen në bashkëpunim të ngushtë me institucionet e arsimit të lartë dhe me industrinë, në mënyrë që zhvillimi i kurrikulave universitare të reflektojë ndryshimet që po ndodhin në tregun e punës. Ai vlerësoi rëndësinë e iniciativave që mbështeten në hulumtime empirike, duke theksuar se vendimmarrja institucionale është më e qëndrueshme kur mbështetet në evidencë dhe në dialog me aktorët e sektorit.

Në këtë frymë, ai përgëzoi Universitetin "Haxhi Zeka" dhe Fakultetin e Menaxhimit të Turizmit, Hotelierisë dhe Mjedisit për organizimin e tryezës dhe për realizimin e hulumtimit, duke e konsideruar atë një kontribut të vlefshëm për diskutimet që lidhen me zhvillimin e arsimit profesional dhe universitar në fushën e hotelierisë.



PROF. DR. AFRIM SELIMI

Prof. Dr. Afrim Selimaj është Dekan i Fakultetit të Menaxhimit në Turizëm, Hotelieri dhe Mjedis në Universitetin "Haxhi Zeka" dhe profesor i rregullt në fushën e ekonomisë. Me një përvojë të gjatë akademike, shkencore dhe menaxheriale, ai ka dhënë kontribut të rëndësishëm në zhvillimin e arsimit të lartë dhe avancimin e programeve studimore. Aktiviteti i tij përfshin mësimdhënien, kërkimin shkencor dhe pjesëmarrjen në projekte zhvillimore, me fokus në ekonomi, marketing dhe menaxhim. Në cilësinë e dekanit, ai është i përkushtuar në rritjen e cilësisë akademike, fuqizimin e bashkëpunimit me institucionet

dhe industrinë, si dhe në përgatitjen e kuadrove profesionale në përputhje me standardet bashkëkohore të arsimit të lartë.

BASHKËPUNIMI UNIVERSITET, INDUSTRI SI BAZË PËR ZHVILLIMIN E KURRIKULAVE

Duke folur në cilësinë e Dekanit të Fakultetit të Menaxhimit të Turizmit, Hotelerisë dhe Mjedisit, **Prof. Dr. Afrim Selimi** e orientoi diskutimin drejt rolit që fakulteti ka në përgatitjen e kuadrove profesionale për sektorin hotelier. Ai theksoi se zhvillimi i programeve studimore nuk mund të jetë një proces i izoluar akademik, por duhet të ndërtohet në bashkëpunim të vazhdueshëm me industrinë dhe me institucionet që veprojnë në këtë sektor.

Në fjalën e tij, Dekani vuri në pah se rezultatet e hulumtimit dëshmojnë qartë nevojën për avancimin e komponentes së menaxhimit hotelier, rritjen e peshës së praktikës profesionale dhe përfshirjen më të madhe të industrisë në procesin e zhvillimit të kurrikulave. Sipas tij, pikërisht këto elemente përbëjnë bazën mbi të cilën fakulteti do të vazhdojë të zhvillojë programet studimore në të ardhmen.

Ai shprehu gjithashtu gatishmërinë e fakultetit për të zgjeruar format e bashkëpunimit me bizneset, duke krijuar partneritete që u mundësojnë studentëve të fitojnë përvojë praktike gjatë studimeve dhe të zhvillojnë kompetenca që kërkohen nga tregu i punës.



METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

Për të siguruar që diskutimet e tryezës të mbështeteshin në të dhëna empirike, Fakulteti i Menaxhimit të Turizmit, Hotelerisë dhe Mjedisit realizoi një hulumtim sasior, i cili u zhvillua përmes një pyetësoi të strukturuar. Në hulumtim morën pjesë 124 subjekte nga sektori i hotelerisë, gastronomisë dhe turizmit në Kosovë. Të dhënat e mbledhura u analizuan në mënyrë deskriptive dhe rezultatet e tyre u përdorën si bazë për diskutimet dhe rekomandimet e prezantuara gjatë tryezës.

PREZANTIMI I HULUMTIMIT

HULUMTIMI SI BAZË PËR DISKUTIMIN MBI ZHVILLIMIN E MENAXHIMIT HOTELIER

Pas fjalëve hyrëse të panelistëve, programi i tryezës vijoi me prezantimin e hulumtimit **"Identifikimi i nevojave për fuqizimin e komponentes së menaxhimit hotelier"**, të realizuar nga Fakulteti i Menaxhimit të Turizmit, Hotelerisë dhe Mjedisit në Universitetin "Haxhi Zeka". Prezantimi u mbajt nga **MSc. Edlira Juniku**, asistente ekzekutive e Rektorit, e cila paraqiti rezultatet kryesore të analizës së zhvilluar me përfaqësues të sektorit hotelier, gastronomik dhe turistik në Kosovë.

Që në fillim të prezantimit u theksua se hulumtimi ishte konceptuar si një instrument për të dëgjuar zërin e industrisë dhe për ta përfshirë atë në procesin e zhvillimit të programeve studimore. Në vend që diskutimet të mbështeteshin vetëm në perceptime apo përvoja individuale, aktiviteti u orientua mbi të dhëna empirike të mbledhura nga vetë bizneset që veprojnë në këtë sektor. Kjo qasje i dha tryezës një karakter analitik dhe krijoi mundësinë që rekomandimet e dala nga diskutimi të mbështeteshin në evidencë konkrete.

Në vijim u prezantua metodologjia e hulumtimit, e cila u realizua përmes një pyetësori të strukturuar, të shpërndarë te subjektet që operojnë në fushën e hotelierisë, gastronomisë dhe turizmit në të gjitha rajonet e Kosovës. Në hulumtim morën pjesë **124 subjekte**, duke siguruar një bazë të gjerë informacioni mbi nevojat aktuale të tregut të punës dhe pritshmëritë e punëdhënësve ndaj institucioneve të arsimit të lartë.

Gjatë prezantimit u bë e qartë se zhvillimi i industrisë së hotelierisë po ecën me ritëm më të shpejtë sesa transformimi i programeve studimore, gjë që krijon nevojën për një dialog të vazhdueshëm ndërmjet universitetit dhe sektorit privat. Për këtë arsye, analiza nuk u kufizua vetëm në identifikimin e problemeve, por u përqendrua edhe në evidentimin e mundësive për avancimin e komponentes së menaxhimit hotelier në kuadër të programeve studimore ekzistuese.

Një nga gjetjet më domethënëse që u prezantua ishte mbështetja pothuajse unanime e punëdhënësve për krijimin e profileve më të specializuara në menaxhimin hotelier. Rezultatet treguan se industria e konsideron të domosdoshëm zhvillimin e programeve që i kushtojnë më shumë vëmendje kompetencave profesionale, organizimit të praktikës dhe përgatitjes së studentëve për situatat reale të punës. Në të njëjtën kohë, u evidentua se programet ekzistuese përbëjnë një bazë të mirë, por kërkojnë përditësim të vazhdueshëm për të reflektuar zhvillimet e industrisë dhe kërkesat e tregut.

Vëmendje e veçantë iu kushtua edhe rolit të praktikës profesionale. Analiza tregoi se bizneset e sektorit e konsiderojnë përvojën praktike si një nga elementet më të rëndësishme në përgatitjen e studentëve, duke vlerësuar se integrimi më i madh i praktikës gjatë studimeve ndikon drejtpërdrejt në rritjen e kompetencave profesionale dhe në lehtësimin e kalimit nga universiteti në tregun e punës. Kjo gjetje u shndërrua në një nga temat që u rikthye vazhdimisht gjatë diskutimeve të panelistëve.

Një tjetër aspekt që tërhoqi interesin e pjesëmarrësve ishte gatishmëria e industrisë për të bashkëpunuar më ngushtë me universitetin. Hulumtimi evidentoi se bizneset shprehin interes për zgjerimin e praktikës profesionale, organizimin e ligjëratave nga ekspertët e industrisë, zhvillimin e vizitave studimore dhe krijimin e marrëveshjeve më të strukturuar të bashkëpunimit. Këto rezultate dëshmuar se ekziston një bazë solide për ndërtimin e partneriteteve afatgjata ndërmjet universitetit dhe sektorit hotelier.

Në përmbyllje të prezantimit u theksua se rezultatet e hulumtimit nuk duhet të shihen vetëm si një analizë e gjendjes aktuale, por si një udhërrëfyes për zhvillimin e ardhshëm të programeve studimore. Në këtë drejtim, u nënvizua se fuqizimi i komponentes së menaxhimit hotelier kërkon një qasje të integruar, ku universiteti, industria dhe institucionet publike ndajnë përgjegjësinë për

përgatitjen e kuadrove profesionale që do të kontribuojnë në zhvillimin e sektorit të hotelierisë në Kosovë.



PANELISTËT

HYSEN SOGOJEVA

Hysen Sogojeva është Kryetar i Odës së Hotelierisë dhe Turizmit të Kosovës dhe një nga përfaqësuesit e sektorit të turizmit dhe hotelierisë në vend. Ai është i angazhuar në promovimin e politikave dhe iniciativave që kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit. Përmes rolit të tij, ka kontribuar në forcimin e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve publike dhe bizneseve të sektorit turistik. Angazhimi i tij synon ngritjen e cilësisë së shërbimeve turistike dhe fuqizimin e rolit të turizmit në zhvillimin ekonomik të Kosovës.

KOMPETENCAT PROFESIONALE NGA PERSPEKTIVA E INDUSTRIËS HOTELIERE

Diskutimi mori një dimension praktik me kontributin e **Hysen Sogojevës**, Kryetar i Odës së Hotelierisë dhe Turizmit të Kosovës, i cili e trajtoi çështjen e kompetencave profesionale nga këndvështrimi i punëdhënësve. Duke u mbështetur në përvojën e sektorit privat, ai evidentoi

ndryshimet që kanë ndodhur në industrinë e hotelerisë dhe pritshmëritë që bizneset kanë sot ndaj të diplomuarve.

Në fjalën e tij u theksua se tregu nuk kërkon vetëm njohuri teorike, por profesionistë që janë të gatshëm të përballen menjëherë me përgjegjësitë e punës. Sipas tij, aftësitë për komunikim, organizim, menaxhim të shërbimeve, zgjidhje të problemeve dhe përshtatje me standardet e industrisë janë bërë po aq të rëndësishme sa edhe formimi akademik.

Ai vlerësoi se rezultatet e hulumtimit pasqyrojnë në mënyrë reale nevojat e sektorit, veçanërisht në pjesën që lidhet me mungesën e profileve të specializuara në menaxhimin hotelier dhe rëndësinë e praktikës profesionale. Në këtë drejtim, ai shprehu gatishmërinë e Odës së Hotelerisë dhe Turizmit për të mbështetur iniciativa që forcojnë bashkëpunimin me universitetet dhe krijojnë mundësi më të mëdha për praktikën dhe punësimin e studentëve.



BAKI HOTI

Baki Hoti është Kryetar i Unionit të Turizmit të Kosovës dhe një njohës i zhvillimit të sektorit turistik në vend. Ai ka kontribuar në promovimin e potencialeve turistike të Kosovës dhe në forcimin e bashkëpunimit ndërmjet operatorëve turistikë dhe institucioneve. Përmes angazhimit të tij, ka mbështetur iniciativa që synojnë zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm dhe përmirësimin e ofertës turistike. Kontributi i tij ka ndihmuar në rritjen e vizibilitetit të Kosovës si destinacion turistik.

TREGU I PUNËS DHE NEVOJA PËR PROFILE TË SPECIALIZUARA

Duke vazhduar diskutimin nga perspektiva e organizatave profesionale, **Baki Hoti**, Kryetar i Unionit të Turizmit të Kosovës, u ndal te ndryshimet që po përjeton tregu i punës dhe ndikimi i tyre në përgatitjen e kuadrove profesionale. Ai argumentoi se zhvillimi i industrisë së hotelërisë ka krijuar nevoja të reja për profile të specializuara, të cilat kërkojnë përgatitje më të thelluar dhe më të orientuar drejt praktikës.

Në analizën e tij, ai vuri në dukje se bizneset po përballen gjithnjë e më shpesh me vështirësi në gjetjen e stafit që zotëron kompetenca specifike në menaxhimin hotelier. Kjo situatë, sipas tij, nuk duhet parë vetëm si sfida për industrinë, por edhe si një mundësi për universitetet që të zhvillojnë programe studimore më të përshtatura me realitetin e tregut.

Ai theksoi se bashkëpunimi ndërmjet institucioneve akademike dhe sektorit privat duhet të jetë një proces i vazhdueshëm, ku industria kontribuon jo vetëm duke ofruar vende praktike, por edhe duke marrë pjesë në diskutimet për zhvillimin e kurrikulave dhe për identifikimin e kompetencave që kërkohen nga punëdhënësit.



LULZIM SYLA

Lulzim Sylja ushtron detyrën e Drejtorit të Departamentit të Turizmit dhe është i angazhuar në hartimin dhe zbatimin e politikave për zhvillimin e turizmit në Kosovë. Ai kontribuon në promovimin e destinacioneve turistike dhe në mbështetjen e projekteve që fuqizojnë sektorin. Puna e tij fokusohet në zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit dhe në bashkëpunimin me akterët relevantë në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

MBËSHTETJA INSTITUCIONALE PËR ZHVILLIMIN E KOMPETENCAVE PROFESIONALE

Perspektiva institucionale e zhvillimit të sektorit u paraqit nga **Lulzim Syla, Drejtor i Departamentit të Turizmit në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit**, i cili trajtoi rolin e institucioneve publike në krijimin e politikave që mbështesin zhvillimin e kapitalit njerëzor dhe ngritjen e cilësisë së arsimit në fushën e hotelerisë.

Në adresimin e tij, ai theksoi se zhvillimi i qëndrueshëm i turizmit dhe hotelerisë kërkon një qasje të koordinuar ndërmjet institucioneve publike, universiteteve dhe sektorit privat. Sipas tij, investimet në infrastrukturë dhe promovimin e destinacioneve turistike duhet të shoqërohen me investime të vazhdueshme në përgatitjen profesionale të burimeve njerëzore, pasi cilësia e shërbimeve mbetet faktori kryesor që ndikon në konkurrueshmërinë e sektorit.

Duke iu referuar temës së tryezës, ai vlerësoi se rezultatet e hulumtimit ofrojnë një bazë të rëndësishme për hartimin e politikave dhe iniciativave që synojnë zhvillimin e kompetencave profesionale në hoteleri. Ai nënvizoi se bashkëpunimi ndërmjet ministrisë, institucioneve të arsimit të lartë dhe industrisë duhet të forcohet më tej, në mënyrë që programet studimore të zhvillohen në përputhje me nevojat reale të tregut të punës dhe me prioritetet strategjike të zhvillimit të turizmit në Kosovë.



Xhevdet Hyseni është Drejtor i Shoqatës PRO IN dhe ka përvojë në menaxhimin dhe zhvillimin e projekteve që lidhen me zhvillimin ekonomik dhe turistik. Ai është i angazhuar në krijimin e partneriteteve ndërmjet institucioneve dhe sektorit privat. Përmes punës së tij, ka kontribuar në fuqizimin e iniciativave që mbështesin zhvillimin lokal dhe promovimin e turizmit.

BASHKËPUNIMI ME INDUSTRIJË SI INVESTIM NË CILËSINË E ARSIMIT

Në vijim të panelit, **Xhevdet Hyseni**, Drejtor i Shoqatës PRO IN, e përqendroi diskutimin te rëndësia e praktikës profesionale dhe partneriteteve ndërmjet universiteteve dhe bizneseve.

Ai argumentoi se bashkëpunimi nuk duhet të kufizohet vetëm në organizimin e praktikës profesionale, por duhet të shtrihet në të gjitha fazat e procesit arsimor. Sipas tij, përfshirja e ekspertëve të industrisë në ligjërata, organizimi i mentorimit profesional dhe zhvillimi i projekteve të përbashkëta krijojnë kushte që studentët të përfitojnë përvoja reale dhe të zhvillojnë aftësi që nuk mund të fitohen vetëm përmes mësimin në auditor.

Duke iu referuar diskutimeve të zhvilluara gjatë tryezës, ai theksoi se bashkëpunimi universitet dhe industri duhet të ndërtohet mbi partneritete afatgjata dhe përgjegjësi të ndërsjella, në mënyrë që studentët të jenë përfituesit kryesorë të këtij bashkëpunimi.



TEUTA KRYEZIU

Teuta Kryeziu është profesoreshë në Shkollën e Mesme Ekonomike dhe kontribuon në edukimin dhe përgatitjen profesionale të gjeneratave të reja. Ajo është e përkushtuar në zhvillimin e kompetencave të nxënësve dhe lidhjen e arsimit profesional me nevojat e tregut të punës. Angazhimi i saj në arsim përfaqëson një kontribut të rëndësishëm në përgatitjen e kuadrove të ardhshme për sektorin e shërbimeve dhe ekonomisë.

NDËRLIDHJA E ARSIMIT PROFESIONAL ME ARSIMIN UNIVERSITAR

Një dimension tjetër i rëndësishëm i diskutimit u trajtua nga **Teuta Kryeziu**, profesoreshë në Shkollën e Mesme Ekonomike, e cila solli perspektivën e arsimit profesional parauniversitar dhe rëndësinë e krijimit të një vazhdimësie ndërmjet nivelit të mesëm dhe studimeve universitare në fushën e hotelevisë.

Në prezantimin e saj ajo theksoi se përgatitja e kuadrove profesionale është një proces që fillon që në arsimin e mesëm dhe duhet të vazhdojë në mënyrë të harmonizuar në universitet. Sipas saj, koordinimi i kurrikulave ndërmjet dy niveleve të arsimit krijon mundësi që studentët të ndërtojnë

kompetencat profesionale në mënyrë progresive, duke shmangur mbivendosjet dhe duke siguruar një zhvillim më të qëndrueshëm të aftësive praktike.

Ajo nënvizoi gjithashtu rëndësinë e komunikimit të vazhdueshëm ndërmjet institucioneve arsimore dhe sektorit privat, në mënyrë që përmbajtja e programeve mësimore të pasqyrojë zhvillimet e industrisë dhe kërkesat që ajo paraqet për fuqinë punëtore. Në këtë drejtim, bashkëpunimi ndërinstitucional u konsiderua si një element kyç për krijimin e një sistemi arsimor që i përgjigjet nevojave të tregut të punës.



RUDINA EFENDIU

Rudina Efendiu është bashkëthemeluese e GUIDEKS, një iniciativë që promovon turizmin përmes inovacionit dhe teknologjisë. Ajo është e angazhuar në krijimin e përvojave autentike turistike dhe në promovimin e trashëgimisë kulturore dhe natyrore të Kosovës. Përmes punës së saj, kontribuon në zhvillimin e produkteve turistike dhe fuqizimin e turizmit lokal.

KOMPETENCAT PROFESIONALE NË NJË INDUSTRI NË TRANSFORMIM

Në vazhdim të panelit, **Rudina Efendiu**, bashkëthemeluese e **GUIDEKS**, e orientoi diskutimin drejt ndryshimeve që po përjeton industria e turizmit dhe hotelierisë si rezultat i zhvillimit të teknologjisë dhe transformimit digjital.

Ajo theksoi se profesionet që lidhen me mikpritjen dhe shërbimet turistike po kërkojnë kompetenca të reja, të cilat shkojnë përtej njohurive tradicionale profesionale. Sipas saj, aftësitë për komunikim ndërkulturor, përdorimi i platformave digjitale, promovimi i destinacioneve dhe menaxhimi i përvojës së klientit janë bërë pjesë e pandashme e profilit profesional që kërkon industria bashkëkohore.

Në këtë kontekst, ajo vlerësoi se programet studimore duhet të zhvillohen paralelisht me ndryshimet teknologjike dhe me praktikat më të mira ndërkombëtare, në mënyrë që studentët të jenë të përgatitur për një treg pune gjithnjë e më konkurrues dhe dinamik.



SADIK MAQEDONCI

Sadik Maqedonci është Drejtor i Departamentit për Hoteleri dhe Gastronomi dhe ka një rol të rëndësishëm në përgatitjen profesionale të kuadrove në këtë fushë. Ai është i përkushtuar në avancimin e

standardeve të arsimit profesional dhe në zhvillimin e kompetencave praktike të studentëve. Përvoja e tij kontribuon në lidhjen e arsimit me nevojat e industrisë së hotelerisë dhe gastronomisë.

PRAKTIKA PROFESIONALE SI PJESË E PROCESIT TË TË NXËNIT

Diskutimi mbi përgatitjen profesionale të studentëve u pasurua më tej nga **Sadik Maqedonci**, Drejtor i Departamentit për Hoteleri dhe Gastronomi, i cili trajtoi rëndësinë e integritetit të praktikës profesionale në procesin e studimeve universitare.

Ai argumentoi se praktika nuk duhet të perceptohet si një aktivitet i veçantë nga procesi mësimor, por si një komponent që plotëson dhe forcon njohuritë teorike të fituara gjatë studimeve. Sipas tij, përfshirja e studentëve në mjedise reale pune krijon mundësi për zhvillimin e kompetencave profesionale, rrit vetëbesimin dhe i ndihmon ata të kuptojnë më mirë standardet dhe përgjegjësitë që karakterizojnë industrinë e hotelerisë.

Në vijim të diskutimit ai vuri në pah se bashkëpunimi ndërmjet universitetit dhe bizneseve duhet të shtrihet përtej praktikës profesionale, duke përfshirë mentorimin, projektet e përbashkëta dhe shkëmbimin e përvojave ndërmjet stafit akademik dhe ekspertëve të industrisë. Një qasje e tillë, sipas tij, kontribuon drejtpërdrejt në ngritjen e cilësisë së arsimit dhe në përgatitjen e studentëve për sfidat e profesionit.



ARLINDA SHOSHI

Arlinda Shoshi është menaxhere në ONIX Spa & Resort dhe ka përvojë në menaxhimin e operacioneve hoteliere dhe ofrimin e shërbimeve cilësore për mysafirët. Ajo kontribuon në zbatimin e standardeve të mikpritjes dhe në zhvillimin e praktikave moderne të menaxhimit hotelier. Angazhimi i saj pasqyron rëndësinë e lidërshiptit profesional në industrinë e hotelerisë.

PRITSHMËRITË E INDUSTRISË NDAJ TË DIPLOMUARVE

Përfaqësuesja e sektorit hotelier, **Arlinda Shoshi**, menaxhere në **ONIX Spa & Resort**, solli në tryezë përvojën e një prej bizneseve që angazhohen drejtpërdrejt në punësimin dhe zhvillimin profesional të kuadrove të rinj.

Në diskutimin e saj ajo ndau përvojat e industrisë lidhur me procesin e rekrutimit dhe integritet të diplomuarve në vendin e punës. Sipas saj, bizneset vlerësojnë formimin akademik, por një rëndësi të veçantë i kushtojnë aftësive praktike, etikës profesionale, komunikimit me klientët, punës në ekip dhe gatishmërisë për të mësuar vazhdimisht.

Ajo theksoi se bashkëpunimi me universitetet krijon mundësi që studentët të njihen me realitetin e industrisë që gjatë studimeve, duke e bërë më të lehtë kalimin nga auditori universitar në tregun e punës. Në këtë drejtim, ajo shprehu gatishmërinë e sektorit privat për të zgjeruar format e bashkëpunimit me institucionet e arsimit të lartë dhe për të kontribuar në përgatitjen e gjeneratave të reja të profesionistëve.



BESNIK BEKTESHI

Besnik Bekteshi është trajner në fushën e housekeeping dhe hospitality, me përvojë në ngritjen e kapaciteteve profesionale të stafit hotelier. Ai është i specializuar në standardet e mikpritjes dhe menaxhimin e shërbimeve hoteliere. Përmes trajnimeve të tij, kontribuon në rritjen e cilësisë së shërbimeve dhe përgatitjen profesionale të punonjësve në sektorin e hotelerisë.

ZHVILLIMI I AFTËSIVE PRAKTIKE SI STANDARD I PROFESIONIT

Në vijim të panelit, **Besnik Bekteshi**, trajner për **Housekeeping** dhe **Hospitality**, e përqendroi diskutimin në një aspekt që shpesh mbetet në hije gjatë përgatitjes akademike të studentëve, zhvillimin e aftësive praktike që lidhen drejtpërdrejt me funksionimin e përditshëm të objekteve hoteliere.

Duke u mbështetur në përvojën e tij profesionale, ai argumentoi se cilësia e një shërbimi hotelier ndërtohet përmes standardeve të punës që aplikohen në çdo hallkë të organizimit. Sipas tij, përgatitja profesionale duhet të zhvillojë jo vetëm njohuritë teknike, por edhe kulturën e përgjegjësisë, disiplinës, organizimit dhe komunikimit, elemente që ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë e shërbimit dhe në përvojën e klientit.

Ai theksoi se industria ka nevojë për profesionistë që janë të gatshëm të punojnë sipas standardeve bashkëkohore të hotelerisë dhe që kuptojnë rëndësinë e detajeve në ofrimin e shërbimeve. Për këtë

arsye, sipas tij, praktika profesionale duhet të zërë një vend qendror në procesin e studimeve, duke u ofruar studentëve mundësinë të njihen me organizimin real të proceseve të punës dhe me kërkesat që karakterizojnë industrinë moderne të mikpritjes.

Në përmbyllje të prezantimit, ai nënvizoi se bashkëpunimi ndërmjet universitetit dhe profesionistëve të industrisë krijon mundësi për transferimin e përvojës praktike te studentët dhe kontribuon në formimin e kuadrove që i përgjigjen më mirë kërkesave të tregut të punës.



PROF. ASOC. ALBERTA TAHIRI

Prof. asoc. Dr. Alberta Tahiri është profesoreshë universitare në Fakultetin e Menaxhimit në Turizëm, Hoteleri dhe Mjedis në Universitetin “Haxhi Zeka”. Fusha e saj e ekspertizës përfshin turizmin e qëndrueshëm, hotelerinë, trashëgiminë kulturore dhe zhvillimin e turizmit. Ajo është autore dhe bashkautore e një numri të konsiderueshëm punimesh shkencore të publikuara në revista ndërkombëtare të indeksuara në bazat më prestigjioze shkencore. Gjithashtu, është autore e librave universitarë në fushat e turizmit, hotelierisë, trashëgimisë kulturore dhe turizmit të qëndrueshëm. Angazhimi i saj akademik përfshin zhvillimin e programeve studimore, mentorimin e studentëve dhe pjesëmarrjen aktive

në projekte dhe konferenca shkencore ndërkombëtare. Përmes punës së saj, ajo kontribuon në forcimin e bashkëpunimit ndërmjet akademisë dhe industrisë, me qëllim avancimin e arsimit të lartë dhe zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit të turizmit dhe hotelierisë në Kosovë.

ANALIZA E NEVOJAVE TË INDUSTRISË DHE ORIENTIMI I ZHVILLIMIT AKADEMIK

Paneli u përmbyll me prezantimin e **Prof. asoc. Alberta Tahiri**, profesoreshë në Fakultetin e Menaxhimit të Turizmit, Hotelierisë dhe Mjedisit, e cila paraqiti një analizë të implikimeve që rezultatet e hulumtimit kanë për zhvillimin e programeve studimore në fushën e menaxhimit hotelier.

Në prezantimin e saj ajo evidentoi se gjetjet e hulumtimit nuk duhet të shihen vetëm si tregues statistikorë, por si një burim i rëndësishëm informacioni për procesin e planifikimit akademik. Sipas saj, të dhënat e mbledhura nga sektori hotelier ofrojnë një pasqyrë të qartë mbi kompetencat që kërkon industria dhe mbi drejtimit ku duhet të përqendrohet zhvillimi i kurrikulave universitare në të ardhmen.

Ajo u ndal veçanërisht te rëndësia e përditësimit të vazhdueshëm të programeve studimore, duke theksuar se universitetet duhet të jenë në gjendje të reagojnë ndaj ndryshimeve që ndodhin në tregun e punës. Kjo nënkupton jo vetëm rishikimin periodik të përmbajtjes së lëndëve, por edhe zgjerimin e komponentes praktike, përfshirjen e ekspertëve të industrisë në procesin mësimor dhe krijimin e mekanizmave të qëndrueshëm të bashkëpunimit me bizneset.

Në përfundim të prezantimit të saj, Prof. Tahiri theksoi se zhvillimi i programeve studimore duhet të mbështetet në dialog të vazhdueshëm me sektorin hotelier dhe në analiza të rregullta të nevojave të tregut të punës. Vetëm përmes një qasjeje të tillë mund të sigurohet që programet universitare të mbeten relevante, konkurruese dhe të orientuara drejt përgatitjes së kuadrove profesionale që i nevojiten industrisë.



DISKUTIMI I HAPUR

KONTRIBUTET E PANELISTËVE DHE PERSPEKTIVAT PËR ZHVILLIMIN E BASHKËPUNIMIT

Pas përfundimit të prezantimeve, tryeza vijoi me një diskutim të hapur, ku u përfshinë panelistët, përfaqësues të institucioneve publike, bizneset e sektorit hotelier, stafi akademik dhe pjesëmarrësit e tjerë. Debati u zhvillua në një atmosferë konstruktive, duke nxitur shkëmbimin e përvojave, ideve dhe propozimeve konkrete për forcimin e bashkëpunimit ndërmjet universitetit dhe industrisë.

Diskutimet u përqendruan në sfidat që lidhen me përgatitjen e kuadrove profesionale, organizimin e praktikës së studentëve dhe nevojën për harmonizimin e vazhdueshëm të programeve studimore me zhvillimet e tregut të punës. Pjesëmarrësit vlerësuan se dinamika e zhvillimit të industrisë kërkon një reagim të vazhdueshëm edhe nga institucionet e arsimit të lartë, përmes programeve studimore fleksibile dhe të orientuara drejt zhvillimit të kompetencave profesionale.

Vëmendje e veçantë iu kushtua bashkëpunimit ndërmjet universitetit dhe bizneseve. Përfaqësuesit e industrisë shprehën gatishmërinë për të zgjeruar mundësitë e praktikës

profesionale, për të kontribuar në organizimin e aktiviteteve akademike dhe për të mbështetur iniciativa që ndikojnë në ngritjen e cilësisë së arsimit në fushën e hotelerisë. Nga ana tjetër, përfaqësuesit e universitetit riafirmuan përkushtimin për të ndërtuar forma më të strukturuar bashkëpunimi, të cilat krijojnë përfitime të ndërsjella për studentët, institucionin dhe sektorin privat.

Në përmbyllje të diskutimit u vlerësua se rezultatet e hulumtimit, të kombinuara me kontributet e panelistëve dhe pjesëmarrësve, krijuan një bazë të rëndësishme për identifikimin e prioriteteve që duhet të udhëheqin zhvillimin e mëtejshëm të programeve studimore në fushën e menaxhimit hotelier. Njëkohësisht, u theksua se zhvillimi i sektorit hotelier dhe përgatitja e kuadrove profesionale kërkojnë angazhim të përbashkët dhe partneritet afatgjatë ndërmjet universitetit, industrisë dhe institucioneve publike.

KONKLuzionet e Tryezës

Diskutimet e zhvilluara gjatë tryezës evidentuan se zhvillimi i sektorit të hotelerisë kërkon një qasje më të integruar në përgatitjen e kuadrove profesionale, ku universiteti, industria dhe institucionet publike ndajnë përgjegjësi të përbashkëta. Kontributet e panelistëve dhe rezultatet e hulumtimit dëshmuuan se ekziston një konsensus i gjerë mbi nevojën për zhvillimin e programeve studimore që reflektojnë ndryshimet e tregut të punës dhe standardet bashkëkohore të industrisë.

Një nga konkluzionet kryesore të tryezës ishte se përgatitja e studentëve nuk mund të mbështetet vetëm në formimin teorik. Zhvillimi i kompetencave profesionale kërkon zgjerimin e komponentes praktike, bashkëpunim më të ngushtë me sektorin hotelier dhe krijimin e mundësive që studentët të përfitojnë përvojë profesionale gjatë studimeve. Në këtë drejtim, praktika profesionale u vlerësua si një element thelbësor për rritjen e punësueshmërisë së të diplomuarve.

Diskutimet nxorën në pah edhe nevojën për një dialog të vazhdueshëm ndërmjet universitetit dhe industrisë në procesin e zhvillimit dhe rishikimit të programeve studimore. Përfaqësuesit e institucioneve dhe të biznesit vlerësuan se bashkëpunimi i institucionalizuar, shkëmbimi i përvojave dhe përfshirja e ekspertëve të industrisë në procesin akademik do të kontribuonin në përgatitjen e kuadrove që i përgjigjen më mirë kërkesave të tregut të punës.

Një tjetër përfundim i rëndësishëm ishte rëndësia e vendimmarrjes së mbështetur në evidencë. Hulumtimi i realizuar nga Fakulteti i Menaxhimit të Turizmit, Hotelerisë dhe Mjedisit u vlerësua si një instrument i rëndësishëm për identifikimin e nevojave reale të sektorit dhe për orientimin e zhvillimit të ardhshëm të programeve studimore. U theksua se analiza të tilla duhet të bëhen pjesë e praktikës së rregullt institucionale, në mënyrë që zhvillimi akademik të mbështetet vazhdimisht në të dhëna dhe në dialog me industrinë.

Përmbyllja e Diskutimit dhe Rekomandimet Kryesore

Në përmbyllje të tryezës, Rektori i Universitetit "Haxhi Zeka", **Prof. Dr. Armand Krasniqi**, bëri një sintezë të diskutimeve të zhvilluara gjatë aktivitetit, duke evidentuar se të gjitha kontributet e panelistëve dhe rezultatet e hulumtimit përçollën një mesazh të përbashkët: zhvillimi i arsimit të lartë në fushën e hotelerisë duhet të mbështetet në bashkëpunim të qëndrueshëm me industrinë dhe në përshtatje të vazhdueshme me zhvillimet e tregut të punës.

Ai theksoi se sfidat e identifikuar gjatë diskutimeve nuk duhet të shihen vetëm si çështje akademike, por si prioritete zhvillimore që kërkojnë angazhimin e përbashkët të universitetit, institucioneve publike, organizatave profesionale dhe sektorit privat. Sipas tij, vetëm përmes një qasjeje të koordinuar mund të krijohen programe studimore që përgatisin profesionistë të aftë për t'iu përgjigjur kërkesave të industrisë dhe për të kontribuar në zhvillimin e sektorit hotelier në Kosovë.

Në përfundim të aktivitetit, Rektori prezantoi përfundimet kryesore që dolën nga diskutimet e zhvilluara gjatë tryezës, të cilat paraqesin një orientim të rëndësishëm për zhvillimin e mëtejshëm të programeve studimore dhe për forcimin e bashkëpunimit ndërmjet universitetit dhe industrisë.

PËRFUNIDME

- Harmonizimi i kurrikulave me standardet më të larta ndërkombëtare dhe me zhvillimet bashkëkohore të sektorit hotelier.
- Përshtatja e programeve studimore me ndryshimet e shpejta që po ndodhin në tregun e punës.
- Trajtimi i kapitalit njerëzor si faktor kyç për zhvillimin e qëndrueshëm të hotelerisë.
- Diferencimi më i qartë i veprimtarive hoteliere dhe turistike, si në aspektin profesional ashtu edhe në atë akademik.
- Institucionalizimi i bashkëpunimit ndërmjet universitetit dhe bizneseve përmes mekanizmave të qëndrueshëm të partneritetit.
- Krijimi i një ndërlidhjeje më të qartë ndërmjet programeve të niveleve IV, V dhe VI sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve në fushën e hotelerisë.
- Fuqizimi i komponentes praktike të studimeve dhe zvogëlimi i hendekut ndërmjet përgatitjes akademike dhe praktikës profesionale.
- Qartësimi i dallimit ndërmjet koncepteve **kualifikim** dhe **certifikim** në procesin e zhvillimit profesional.
- Zhvillimi i mëtejshëm i kompetencave digjitale si pjesë përbërëse e profileve profesionale.
- Krijimi i një baze të të dhënave për identifikimin e kapaciteteve, njohurive dhe kompetencave që industria mund të ofrojë në mbështetje të programeve studimore.
- Promovimi i konceptit të mësimit gjatë gjithë jetës si element i zhvillimit të vazhdueshëm profesional.
- Rritja e rolit të institucioneve publike, në nivel lokal dhe qendror, në hartimin dhe zbatimin e politikave për zhvillimin e sektorit hotelier.
- Zhvillimi dhe promovimi i modelit të mësimit dual.
- Përmirësimi i imazhit të sektorit të hotelerisë dhe rritja e atraktivitetit të profesioneve të kësaj fushe për të rinjtë.

- Zhvillimi i mëtejshëm i aftësive praktike në hoteleri dhe përfshirja e tyre në kuadër të strategjive kombëtare për zhvillim ekonomik dhe turistik.
- Integrimi më i madh i marketingut digjital në programet studimore dhe në praktikën profesionale.
- Përmirësimi i sistemit të mentorimit gjatë praktikës profesionale, përfshirë përgatitjen e mentorëve në biznese dhe zhvillimin e shkathtësive të buta të studentëve.

VLERA INSTITUCIONALE E TRYEZËS

Përtej diskutimeve profesionale dhe shkëmbimit të përvojave ndërmjet panelistëve, tryeza shënoi një hap të rëndësishëm në forcimin e bashkëpunimit ndërmjet Universitetit "Haxhi Zeka", institucioneve publike dhe sektorit hotelier. Aktiviteti dëshmoi rëndësinë e ndërtimit të një dialogu të vazhdueshëm ndërmjet akademisë dhe industrisë, si një mekanizëm i domosdoshëm për zhvillimin e programeve studimore që u përgjigjen nevojave reale të tregut të punës.

Gjetjet e hulumtimit, diskutimet e zhvilluara dhe rekomandimet e prezantuara gjatë tryezës krijojnë një bazë të vlefshme për zhvillimin e mëtejshëm të programeve studimore, forcimin e partneriteteve me industrinë dhe planifikimin e aktiviteteve të ardhshme akademike e hulumtuese. Njëkohësisht, ato përbëjnë një referencë të rëndësishme për proceset e sigurimit të cilësisë, rishikimit të kurrikulave dhe avancimit të bashkëpunimit institucional në funksion të përgatitjes së kuadrove profesionale për sektorin e hotelerisë.



KORRIK 2026